



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 1384 prot.

Tiranë, më 8.5.2019

Lënda: Njoftim për shpallje konkurimi

DREJTORIVE NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË DOGANAVE
DEGËVE DOGANORE

Për publikim: **DREJTORISË SË BURIMEVE MBËSHTETËSE**

Drejtorja e Përgjithshme e Doganave, në zbatim të Ligjit 102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjit 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe VKM-së nr. 921 datë 29.12.2014 “Për personelin e Administratës Doganore”, i ndryshuar, shpall konkurimin e hapur për pozicionin:

Koordinator për Skanimet, Drejtorja Antitrafik, pranë Departamentit Operativ Hetimor,
Kategoria C1, Kategoria e Pagës III-b, 1 (një) vend pune

Kandidatët që do të aplikojnë duhet të plotësojnë këto kritere:

1. Të kenë shtetësi shqiptare
2. Të kenë zotësi të plotë për të vepruar
3. Të gëzojnë shëndet të mirë për të kryer detyrat e tyre
4. Të mos kenë qenë të dënuar me vendim penal të formës së prerë
5. Të mos kenë qenë larguar më parë nga administrata shtetërore për thyerje të disiplinës ose shkelje të tjera serioze
6. Të zotërojnë diplomë të nivelit Master Profesional në Shkencat Ekonomike, Juridike, Natyrore, Politeknike, ose të lidhura me Sigurinë dhe Hetimin
7. Përvojë pune deri në 1 (një) vit
8. Të ketë njohuri të paktën të një gjuhe të huaj.

Avantazhe:

Të ketë njohuri në fushën doganore.

Përshkrim përgjithësues për pozicionin:

- Vepron si specialist në Drejtorinë Antitrafik për kryerjen e detyrave të postmbajtësit në përputhje me sistemin e vlerësimit të ngritur në ADSH për këtë qëllim.
- Siguron një zbatim të drejtë e të paanshëm të ligjit në fushën e doganave për çështje dhe praktika të cilat lidhen me skanimet.
- Përdor njohuritë dhe ekspertizën në trajtimin e praktikave që i ngarkohen dhe transmeton tek eprori i drejtpërdrejtë të gjithë problemet, pyetjet lidhur me praktika të ndryshme që i ngarkohen.
- Vepron si përfaqësues i ADSH, kur i ngarkohet detyrë, dhe merr pjesë në konferenca, seminare, takime të ndryshme brenda dhe jashtë vendit që kanë të bëjnë me objektin e Drejtorise ku punon.
- Komunikon dhe merr mendim teknik me shkrim ose me gojë, sipas rastit, nga strukturat e administratës doganore /institucione/ të cilat kanë lidhje me praktikat e skanimeve.
- I kthen përgjigje praktikave të përditshme që i ngarkohen. Jep këshillim për strukturat doganore për çështjet që lidhen me objektin e punës ku punon kur kjo kërkohet.
- Administron kopjet e shkresave për praktikat e trajtuara në linjën e tyre të punës dhe ruan konspiracionin në përputhje me ligjin për sekretet shtetërore.
- Gëzon të gjitha të drejtat e njohura nga legjislacioni doganor dhe ai i punës.

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Kërkesë për marrje pjesë në konkurim
2. Curriculum Vitae
3. Fotokopje e Diplomës dhe Lista e Notave të noterizuara (*Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit*)
4. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore /dëshmi penaliteti
5. Vërtetim nga Gjykata
6. Vërtetim nga Prokuroria
7. Vërtetim nga Tatim-Taksat
8. Vërtetim të gjendjes shëndetësore
9. Fotokopje të letërnjoftimit (ID)
10. Fotokopje të librezës së punës;
11. Letër reference dhënë nga eprori direkt i pozicionit të fundit të punës

12. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj

Nuk pranohen në konkurim kandidatët që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara më sipër.

Procedura e konkurimit do të zhvillohet në dy faza.

Në fazën parakualifikuese kandidatët do të vlerësohen nga dokumentacioni i paraqitur nëse plotësohen kërkesat për konkurim. Aplikantët të cilët nuk arrijnë të plotësojnë kërkesat e përcaktuara skualifikohen.

Faza e dytë do të vijojë me kandidatët e kualifikuar për të marrë pjesë në intervistë. Rezultatet e intervistës bazohen në:

- a) Pervojën
- b) Kualifikimin
- c) Aftësitë

Kandidatët e përzgjedhur duhet të marrin mbi 70 pikë në intervistë.

Data e intervistës do të caktohet në një njoftim të dytë.

Rezultatet e konkurimit

Lista me kandidatët fitues, do të shpallet në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar brenda datës 18.05.2019, ora 16:00 pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore/ Zyra Sekretari/Protokollit.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Arlind Gjokuta

